

VENDIM
Nr.54, datë 3.8.2009

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, 9, 13, pika 1, germa “ç”, dhe nenit 45 pikat 3, 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, germa “f”, 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.8.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.35, datë 7.5.2009.

- Dokumentacioni për aplikimin për licencimin për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike është paraqitur i plotë konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EFT Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike me afat të vlefshmërisë së licencës 5 vjet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta